

E ENJTE DATA 23 SHKURT 2023

FJALA E DEPUTETIT AGRON GJEKMARKAJ

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Një nga gjërat që na ka mbajtur larg nga Europa në kohët moderne, pas pushtimit të gjatë otoman, është fakti se sistemi politik që na u imponua, nuk e pranonte opozitën dhe opozitarizmin. Sapo lindën opozita dhe opozitarizmi në këtë vend, në të njëjtën kohë nisi përpjekja për shtetin e së drejtës, për integrim, për mendësi, për kulturë, për standarde, për sjellje dhe për ligje europiane. Kjo aulë, në vetvete, është dëshmia e realitetit të shndërruar në iluzion dhe e iluzionit që mbetet realitet. Më shumë se kudo tjetër, këtu është folur për Europën dhe për lidhjen jetike të vendit tonë me të. Fjala “integrim” është më e përdorura në këto 32 vjet liri, më e keqpërdorura njëkohësisht, më e dashura dhe më nazikja. Të gjithë, në mënyrën tonë, mundohemi të flirtojmë me të. Ajo ka mbetur, ashtu si në antikitet, një bukuri magjepsëse, por e pakapshme, e cila na fton, si Zeusin, të transformohemi në dema të bardhë për ta joshur, por ëndja jonë e bind atë ngadalë, segmente-segmente, aq sa na krijon perceptimin se kemi të bëjmë me një vijë horizonti, së cilës sa më shumë i afrohem, po aq ajo na largohet. Ajo na dukej më afër, kur në tokën tonë vinte Papa Gjon Pali, Presidenti Bush, Papa Françesku, sekretarët Klinton dhe Kerri, Kancelarja Merkel apo të gjithë liderët e Europës, kryesuar nga Sholc, Makron, Meloni e të tjerë, së bashku në një samit, por jemi ende shumë larg, kur mbetemi këtu vetëm me njëri-tjetrin. Atyre europianëve rendim t’u demonstrojmë me garë frenetike gjithçka Perëndimore ruajtëm nëpër shekuj: kode zakonore, ungjij, xhubleta, epos, fustanella, polifoni, gjuhë, beteja për civilizim, papë, heronj, shenjtorë e shkrimtarë dhe, sapo ata ikin, kthehemi te fatalitetet, te krusmat, te përqaqimet e hidhura, te mentalitetet apo te flama që na mbajti larg saj, ku hileja i zë vendin rregullit, ku uni sakrifikon të tërën, ku autoritarizmi përzë tolerancën, ku interesi mund të ardhmen. Në emër të Europës dhe të integritit në të, kemi akuzuar njëri-tjetrin në mënyrë shfarosëse, të egër dhe aspak europiane.

Në kryeqytetet e kontinentit, opozita dhe pushteti janë kundërshtarë që ndahen për ide dhe programe, pa thyer një kontekst etik, atë lubrikant human, i cili frymëzon sistemin demokratik. Ne jemi mësuar me të gjithë progresin e bërë nga firmosja e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, nga statusi kandidat, nga çelja e negociatave për anëtarësim. Çfarë s'kemi parë, dëgjuar e përlypur! Pushteti gjithmonë ka marrë dhe merr çdo meritë dhe kemi pranuar që opozita të zhvishet nga to. Kemi parë, sipas vizioneve danteske, sesi engjëjt me aurë rrezatuese mbi kaptinë mbretërojnë në qiell dhe djajtë rrinë poshtë me këmbë në akull; sesi rrëkeja e fjalëve pa mbarim, pa fisnikërinë e Don Kishotit, ndan të mirën dhe të keqen; sesi zelli i pafund dhe pakufi prej jagove pozicionon europianët përkundëjt anadollakëve; sesi jemi të etur, si udhëtarët e shkretëtirës, në përvetësim meritash dhe të pamëshirshëm, si piratët, në zhveshjen e tjetrit nga çdo begenisje a stoli virtyti. Po, kundërshtari kudo duhet mundur, por nuk duhet të çnjerëzohet, nuk duhet të ndyhet, nuk duhet të dënohet nga gjykatat, edhe kur kryen një shërbesë publike dhe këtu kemi një rast të afërt, atë të deputetit Salianji. Në vendet e emancipuara nderimi për kundërshtarin është detyrë, nuk mungon, kurse këtu urrejtja për kundërshtarin është detyrë që stimulohet. Sot, në këtë pikë të rendit të ditës, flitet për rolin e

Kuvendit në procesin e integritimit europian. Në mos shaka, paradoks ngjan! Kuvendi ynë është kthyer në gjykatë, e cila ngre pretenca dhe merr vendime se si të ndëshkohen masivisht deputetët e opozitës për qëndrimet dhe për fjalët e tyre. Precedenti i gjykimit këtu brenda, për atë që thuhet jashtë, është shumë i rëndë. Deri tani janë ndëshkuar 25 deputetë. Ata po kërkojnë një gjë të thjeshtë, përtej formës që detyrohen të përdorin, kërkojnë ardhjen e Kryeministrit në sallë për debat, për një çështje sensitive, si ajo që tani ka emrin McGonigal. Ne mbase nuk e duam njëri-tjetrin, por nuk e zgjedhim ne njëri-tjetrin, është kontrata me Kushtetutën që na detyron ta pranojmë njëri-tjetrin. Ndoshta edhe në grupin e Partisë Demokratike ka nga ata që nuk më duan mua dhe unë ndonjë prej tyre, por kjo nuk është më çështje dëshirash, i bie të jetë çështje këndvështrimi emocional dhe interesi vetjak. Ne jemi përfaqësuesit, për të cilët shqiptarët kanë votuar. Secili këtu, së paku, duhet të respektohet si deputet. Askush nuk mund të silllet këtu si mësues i dobët që, kur nuk i pëlqen pyetja e nxënësit, e nxjerr atë jashtë nga salla. Nëse mazhoranca nuk zbaton rregullat kushtetuese, s'ka pse i kërkon ato tek opozita, sepse edhe sikur ajo t'i zbatonte, njëanshmëria do ta përmbyste barkën. Ky është një mekanizëm, ku njëra pjesë kushtëzon tjetrën. Unë nuk di t'i bie bilbililit dhe as nuk kam ndër mend të mësoj, por, kur mohohet një e drejtë themelore, është themelore ta mbrosh atë, përtej instrumentit që përdor.

Ligjet, rregullat janë shkruar që Kuvendi të ekzistojë si sallë përballjeje, që njerëzit të mos përplasen në rrugë, që konflikti të mos konturojë fizionominë e shoqërisë, që dhuna e një individi apo grupi të mos prevalojë mbi atë të ligjit. Në këtë kontekst, Kryeministri dhe çdokush këtu nuk mund ta zgjedhin opozitën që dëshirojnë dhe as opozita Kryeministrin dhe mazhorancën që do, por ky dhe kjo e fundit kanë detyrimin kushtetues ta përfillin parlamentin, ta respektojnë atë, qeveria po ashtu, në mënyrë që debati të konsumohet në brendi dhe në formë, në kufij demokratikë dhe jo anarkikë. Nuk mund të flitet për proces integruar, nëse nuk pranohet opozita si njësi institucionale dhe si realitet shoqëror. Mbase duhet rikujtuar fakti që në opozitë nuk janë vetëm 63 përfaqësuesit e saj në sallë, por mbi 730 mijë votuesit e saj dhe familjet e tyre, pra gjysma e Shqipërisë. Të nderuar kolegë, Kjo vetëdije duhet t'ju udhëheqë në çdo vendim dhe jo gara e brendshme, juaja dhe jona, se kush duhet të duket më radikal, më trim, më besnik dhe më i vendosur për të hedhur në erë çdo urë bashkëpunimi dhe njerëzie. Kësisoj karriera jonë mund të marrë për mbarë, por gjendja psikologjike e Shqipërisë merr mbrapsht, ajo bëhet depresive. Në tokën e urrejtjes dhe të armiqësisë vazhdimisht rriten heshta dhe hunj. Asnjë themel stabiliteti nuk hidhet në të.

Në kohët kur po na bie për hise të jemi pranë politikës, pa e bërë atë, se sfida e violencës i ka zënë vendin arsyes, duhet të meditojmë mbi faktin dramatik që shqiptarët po shkojnë të integrohen në Europë nëpërmjet emigracionit, pasi po prekin dështimin për ta ndërtuar Europën këtu. Secili e di që, sa më shumë Europë të ketë këtu, do të ketë më pak sundim, më pak arrogancë, më pak idiotësi, më pak injorancë, më pak korrupsion dhe më pak mazohizëm politik, por bashkëqytetarët tanë kanë të drejtë të kenë si njësi matëse jetën e tyre dhe të fëmijëve të tyre, e cila nuk mbushet me fjalët tona shpeshherë bajate. Ky parlament ka miratuar shumë ligje europiane ndër vite, por ligjet të cilat duhej ta rregullonin jetën shoqërore, nuk ia kanë dalë t'i bëjnë ligjëbërësit të ndihen europianë dhe të sillen si të tillë. Nuk mjaftojnë ligjet për t'u ndier europianë, duhet diçka më shumë: e kemi ose nuk e kemi, duam ta gjejmë ose nuk duam ta gjejmë! Shpesh ne kemi bindjen se ua hedhim europianëve, i gënjejmë paq, u shesim mend dhe i shkelim syrin njëri-tjetrit. Nuk e ndaj dot saktë, nëse ky është superioritet apo inferioritet, por përfundimi është se ata nuk na besojnë, nuk na konsiderojnë, nuk na marrin seriozisht dhe na lënë këtu në mahinë tonë, në akrahallëkun tonë, duke i ulëritur dhe duke i vërshëlyer njeri-tjetrit, pikërisht në Kuvendin e Republikës, si pasqyra më perfekte e dështimeve tona. Kuvendi fillon të përmbushë misionin e vet, edhe integruar, atëherë kur pranon opozitën, të drejtën e saj, dhe heq dorë nga koncepti i unifikimit të partisë-pushtet me shtetin. Në një shoqëri demokratike pushteti nuk është hierarki klerikale, që godet vesin në emër të virtetit, por pjesë e sistemit etikisht të barabartë me opozitën dhe, si e tillë, gjykohet nga votuesit, nga elektorati, nga shoqëria, nga opinioni

apo nga drejtësia. Interpretimet e tjera, qoftë për pushtetin, qoftë për opozitën, janë justifikim për evazionet e karaktereve, të cilat do të mbijetojnë për sa kohë shoqëria i toleron, për fat të keq ndoshta gjatë. Faleminderit!